REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Borezuar / Primljeno / Prodato / Received / Delivery 30 . 11 . 2018 viti / god / year

Organi/Njësia / Organ/Jedinica / Org./Unit	Nr.Prot: / Br.Prot: / Prot.No:	Sasija / Prilog / Appendix	Numri / Komuna / Quantity
SKPMSHCK	7248/2018		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 344 /2018
Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 dhe nenit 19 paragrafit 1,5 nën paragrafit 5.1, dhe paragrafit 8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi shqyrtoi raportin me rekomandimin e Kolegjit të Këshillit për mbikëqyrjen e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike''Ali Hadri'' në Komunën e Pejës, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET si e rregullt** procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike''Ali Hadri'', në Komunën e Pejës, sepse është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

II. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Pejë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, si dhe të njëjtin t'ua dërgoj kandidatëve në procedurë të rekrutimit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Arsyetim

1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 08.10.2018 nëpërmjet njoftimit nga Komuna e Drenasit, që më datë 14.08.2018 ka rishpall konkursin e jashtëm për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike''Ali Hadri'', në Komunën e Pejësës, duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, respektivisht shkresës së aprovimit për autorizim të shpalljes së jashtme të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil të datës 16.08.2018.

2. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 08.10.2018 merr Vendimin me numër V.nr.386/2018 me të cilin bënë emërimin e Kolegjit lidhur me vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike''Ali Hadri'', në Komunën e Pejës.

3. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, ka konstatuar se kriteret dhe kushtet e përcaktuara në konkursin e shpallur për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike''Ali Hadri'', në Komunën e Pejës, kanë qenë:

   - *Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;*
   - *Të ketë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimi prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;*
   - *Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit;*
   - *Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim,*
   - *Të kenë se paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucion të arsimit.*

4. Këshilli, ka konstatuar se Komuna e Pejës me datë 16.10.2018 ka përcjell tërë materialin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit. Kolegji për mbikëqyrje, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar se Drejtori për Arsim i Komunës së Pejës, me datë 14.09.2018, ka nxjerr Vendimin me numër Nr.01-11148070për themelimin e Komisionit Përzgjedhës prej pesë (5) anëtarëve, me këtë përbërje:
   1. *Agim Kastrati-kryetar;*
   2. *Valdet Istogu-anëtar;*
   3. *Arian Mustafa (MASHT)-anëtar*
   4. *Zahrije Podrimqaku-Përfaqësues i Këshillit Drejtues-anëtar*
   5. *Arbreshë Sejda-Përfaqësues i mësimdhënësve-anëtar.*

5. Këshilli, ka konstatuar se për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike ''Ali Hadri'' në Komunën e Pejës, kanë aplikuar tetë (8) kandidatë si në vijim:
   1 *Arif Ademaj,*
   2 *Agim Mulliqi,*
   3 *Bajram Shala,.*
   4 *Rifat Haxhijaj,*
   5 *Avdyl Gashi,*
   6 *Esat Berisha,*
   7 *Xhevdet Hasanmetaj,*
   8 *Naim Husaj.*

6. Këshilli, gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve dhe në bazë të Formularit "C" në listën e shkurtër janë përfshirë tetë (8) kandidat si në vijim: *Arif Ademaj, Agim Mulliqi, Bajram Shala, Rifat Haxhijaj, Avdyl Gashi, Esat Berisha, Xhevdet Hasanmetaj dhe Naim Husaj*, të cilët i kanë plotësuar kushtet në bazë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

7. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar, se testimi me gojë i kandidatëve është mbajtur me datë 20.09.2018, dhe kanë marrë të gjithë kandidatët e listës së ngushtë.

8. Këshilli, gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të dërguar nga Komuna e Pejës me datë 16.10.2018, ka konstatuar që Komisioni Rekrutues për vendin e punës Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike''Ali Hadri'', ka rekomanduar kandidatin Arif Ademaj, i cili posedon:
   - **Diplomën:** e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës të lëshuar më datës 20.09.1985 me të cilën dëshmohet se më datë 18.09.1985 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë, duke marr titullin "Profesor i Biologjisë",
   - **Përvoja e punës:** sipas Vendimit me numër 5671/18 të datës 09.09.2018 të Shkollës Fillore Mesme Ulët ''Ramiz Sadiku'', nga viti 2003 ka përvoje pune 15 vite në ushtrimin e detyrës Drejtor Shkollore, nga data 25.01.2016 deri me datës 25.01.2020, në pozitë: Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike ''Ramiz Sadiku'', sipas Vendimit të datës 25.01.2016 lëshuar nga Komuna e Pejës.
   - Licencën e mësimdhënësit Nr.100018052 lëshuar nga MASHT te dt.13.12.2013 deri me dt.13.12.2018 dhe
   - Certifikatën e udhëheqjes të lëshuar nga MASHT- GIZ, në programin ''Ndërtimi i kapaciteteve të drejtoreve te shkollave për përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës'',

9. Bazuar në nenin 19 paragrafin 4 dhe 5 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Anëtari i Kolegjit për mbikëqyrje ka paraqitur raportin me rekomandimin që të aprovohet si e rregullt procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike''Ali Hadri'' në Komunën e Pejës.

10. Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datën 15.11.2018 pasi shqyrtoj raportin e paraqitur nga Kolegji për mbikëqyrje, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

11. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës, Kryetari i Këshillit dhe personat kompetent i ndërmarrin veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: *Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.*

Vendimi i dërgohet:
- *Anëtarëve të Këshillit;*
- *Kryetarit të Komunës së Pejës dhe*
- *Arkivit të Këshillit.*

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit